



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1020/26 Datë: 29.06.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 151 të mbajtur më 16.06.2026, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimeve i Kolegjit AAB për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):
 - *Teknik Dentar, (BSc) 180 ECTS me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji AAB që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji AAB të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji AAB brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Teknik Dentar, (BSc) 180 ECTS	Teuta Kutllovci Manushaqe Selmani Bukleta Blerim Mehmeti

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Teknik Dentar, (BSc) 180 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 01.06.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 151-të, të mbajtur më datë 16.06.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekipi i ekspertëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

